



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 352 prot.

Tepelenë, më 21.02.2025

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË Z. TËRMET PEÇI

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e Enjte më datë 27.02.2025, ora 10:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 30.01.2025.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Janar 2025".
4. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Janar 2025".
5. **Projektvendim:** "Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2024".
6. **Projektvendim:** "Për detajimin e plan - buxhetit për të ardhurat e trashëguara nga viti 2024, dhe disa ndryshime në vendimin e këshillit të bashkisë nr. 72 datë 27.11.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025".
7. **Projektvendim:** "Heqje nga fondi kullosor i Bashkisë Tepelenë".
8. **Projektvendim:** "Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasuritë nr. 87/25 ZK 3661 ndodhur në fshatin Turan, Bashkia Tepelenë".

9. **Projektvendim:**“Për administrimin e efekteve të raportit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe raportit të grupit të punës lidhur me pasuritë nr. 24/88-ND1, 24/88-ND2, 24/91-ND1, 24/91-ND2, 24/88-ND1, 24/88-ND2, 24/95-ND, në referencë të vendimit Nr. 16, datë 27.02.2024 “Për miratimin e nisjes së procedurave nga Bashkia Tepelenë për zhvillimin e pasurive nr. 24/83, 24/88, 24/90, 24/91, 24/95, 24/110, 24/117, 24/19, 24/120, zona kadastrale nr. 3574, pronësi shtetërore, në përdorim/administrim të Bashkisë Tepelenë”.
10. Raport për vendimarrjen dhe performancën e Këshillit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2024.
11. Çështje të tjera.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË



Arben GUMENI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 352/1 prot.

Tepelenë, më 21.02.2025

Lënda: Njoftim për mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak .

ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME :
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAZHIMIT FINANCIAR
DREJTORIA LIGJORE DHE SHËRBIME ORGANIZATIVE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA ARSIM KULRURËS /KUJDESIT SOCIAL

Ju njoftojmë se mbledhjet e Komisioneve të Përhershme për shqyrtimin e projektvendimeve do të zhvillohen në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

1.1 .Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, ditën e Mërkurë datë **26.02.2025 ora 12.00 për pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, të rendit të ditës**

- | | |
|-------------------|------------|
| • Matilda Çela | Kryetare |
| • Latif Kaçaj | N/ Kryetar |
| • Vladimir Gjonça | Anëtar |

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Arben GUMENI

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

www: www.tepelena.gov.al

E-mail: info@tepelena.gov.al

